

PROGRAM PUNE**PËR ZHVILLIMIN E FAKULTETIT TË EDUKIMIT DHE FILOLOGJISE****UNIVERSITETI “FAN S. NOLI” KORÇË****PERIUDHA 2020-2024****Drejtimit kryesore****Te nderuar kolegë**

Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë është një qendër edukimi për studentët dhe për përparimin e dijes, ku të gjithë ne jemi të përfshirë, si kontribues apo si të interesuar.

Arritjet e deritanishme në përbërësit kryesorë të veprimtarisë sonë janë fryt i punës, përpjekjeve dhe investimit, seriozitetit dhe përgjegjshmërisë të gjithsecilit, i bashkëpunimit të autoriteteve dhe organeve drejtuese me gjithë stafin. për periudhën që po lemë pas. Vlerësimi i eksperiencës dhe domosdoshmëria e vazhdimësisë së punës për konsolidimin e tyre përballë sfidave të reja janë motive të fuqishme për drejtuesit e rinj të Fakultetit të Edukimit dhe Filologjisë.

Përvoja ime si pedagog, drejtues për dy mandate i Departamentit të Gjuhëve të huaja, si anëtar senati dhe dekan i fakultetit në mandatin që po lemë pas, angazhimi profesional, ai menaxhues dhe bashkëpunimi i suksesshëm me kolegët, vartës apo eprorë të mij, janë arsye të forta që nxitin rikandidimin për postin e rëndësishëm të drejtuesit të njësisë kryesore.

Misioni dhe Vizioni i Fakultetit të Edukimit dhe Filologjisë

Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë ka për qëllim t’u ofrojë studentëve një edukim cilësor, teorik dhe praktik, për t’u përshtatur

mirë dhe shpejt në tregun e punës. Këtë mision stafi i tij synon ta realizojë nëpërmjet krijimit të një strukture që ofron në vijimësisht studime të thelluara, nëpërmjet mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe partneriteteve me tregun e punës.

Në këtë këndvështrim, cilësia është ajo që përcakton drejtimit strategjike të aktivitetit në fakultet brenda kuadrit të zhvillimit strategjik të Universitetit “Fan S. Noli”.

Për të realizuar rritjen e cilësisë ne do të veprojmë dhe drejtojmë punën për rritjen e përgjegjësisë të strukturave përkatëse të cilat do të punojnë për vlerësimin e brendshëm. Do të rritet më tej pjesëmarrja aktive dhe angazhimi i studentëve në këtë proces të rëndësishëm e jetik i cili do të finalizohet me akreditimin e programeve të studimit sipas Kodit dhe standardeve shtetërore të cilësisë.

Qendra e Ekselencës, do të forcojë rolin e saj të pazëvendësueshëm në bashkërendimin e përvojës, përpjekjeve dhe punës për realizimin e formimit të vazhdueshëm kualifikimit dhe trajnimeve profesionale për mësuesit në detyrë dhe kategori të tjera të interesuara. Kjo njësi do të dinamizojë edhe marrëdhëniet me studentët e sapo diplomuar duke ndjekur edhe ecurinë e karrierës së tyre profesionale.

Drejtimi kryesor në të cilin synon të përqendrohet strategjia e zhvillimit të fakultetit nën mandatin tim të dytë do të jetë ***krijimi i një raporti më të harmonizuar midis mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, si dhe rritja e rolit që kanë strukturat e të nxënies gjatë gjithë jetës në zbatimin e njohurive të këtyre të fundit në fusha apo aktorë që lidhen me punësimin dhe vlerën e diplomave.***

1. Programet e studimit, mësimdhënien dhe mësimnxënien.

Strategjitë që lidhen me mësimdhënien dhe mësimnxënien do të synojnë:

- 1.1 Kurrikula bashkëkohore, teorike dhe praktike, të orientuara nga zhvillimet kombëtare në tregun e arsimit dhe më gjerë që do të kenë si bosht promovimin e etikës profesionale dhe formimin qytetar demokratik të diplomantëve tanë. Strategjia synon konsolidimin e kurrikulave ekzistuese në bachelor dhe master që synojnë të tërheqin në fakultet kandidatët maturantë që paraqesin një profil profesional punësimi në lidhje me mësimin dhe filologjinë. Gjithashtu do të synohet hapja e programeve të reja bachelor, master dhe profesionale dy-vjeçare të cilat kërkohen në tregun e punës.
- 1.2 Reformim të syllabuseve të programeve të studimit duke realizuar kërkesat e reformimit të përmbajtjes së kurrikulës të arsimit parauniversitar dhe ato të ligjit të ri për mësimdhënien në bazë të kompetencave. Në hartimin e syllabuseve të reja do të pasqyrohet edhe roli dhe pjesëmarrja më aktive e studentëve.

- 1.3 Pedagogji produktive dhe gjithëpërfshirëse që mbështesin intelektualisht të gjithë studentët, por që respektojnë e përfshijnë edhe ndryshimet midis tyre. Kjo do të arrihet duke vendosur në modulet e ndryshme synime dhe objektiva të diferencuara fleksible dhe dinamike të cilat do t'i përgjigjen niveleve të ndryshme të përparimit të studentëve.
- 1.4 Proceste rigoroze dhe transparente të sigurimit të cilësisë, që informojnë për të gjitha aspektet e kurrikulave të Fakultetit të Edukimit dhe Filologjisë, që rrisin besimin dhe sigurojnë rezultate të kënaqshme. Strategjia synon forcim të strukturave të sigurimit të brendshëm të cilësisë nëpërmjet zgjerimit të gamës së formave dhe të përfshirjes së stafit akademik dhe studentëve në proceset ku ndihet nevoja për përmirësim. Përvoja e krijuar tashmë në këtë drejtim ka krijuar një truall të besueshëm mbi të cilin stafi akademik do të përfshihet më tepër në aktivitete brenda dhe jashtëkurrikulare që lidhen me kurrikulën, kërkimin shkencor dhe marrëdhënien me tregun e punës. Nga ana tjetër, ndërgjegjësimi i studentëve dhe rritja e besimit të tyre se sugjerimet e bëra në lidhje me procesin mësimor dhe vlerën e diplomave, janë parësore.
- 1.5 Për këtë është e nevojshme që struktura të posaçme në njësitë bazë, në bashkëpunim me Qendrën e Karrierës të krijojnë një strategji të mirëfilltë që synon si përfshirjen e studentëve aktualë në veprimtari universitare, ashtu edhe

fushatat e promovimit apo ruajtjen e lidhjeve me studentët e diplomuar.

- 1.6 Vënia në funksion të plotë i infrastrukturave që do të realizojnë shkëmbimin e përvojave reale të mësimdhënies mes institucioneve simotra, me të cilat ne tashme kemi krijuar marrëdhënie formale bashkëpunimi. Leksione, trajnime, promovime veprimtarish mësimdhënieje të përbashkëta, krijimi i programeve të studimit të përbashkëta, promovimi i përvojave studentore, etj.

2. Kërkimi shkencor.

Strategjitë që lidhen me *kërkimin shkencor* do të synojnë:

- 2.1 Një profil kërkimi të qartë dhe të fokusuar, i cili do t'i japë Fakultetit të Edukimit dhe Filologjisë një identitet, njohje dhe impakt në fusha të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare kërkimi që kanë të bëjnë me kërkimet e aplikuara në shkencat e gjuhësisë, letërsisë, gjuhëve të huaja, historisë dhe gjeografisë si edhe me pedagogjinë dhe didaktikat e këtyre fushave.

Axhendë produktive kërkimi për secilin anëtar të stafit akademik të fakultetit, e cila do të zbatohet falë përfshirjes konkrete të strukturave që do të merren me cilësinë e kërkimit shkencor dhe që do të synojë vënien e kërkimit shkencor në dispozicion të mësimdhënies në secilin program studimi. Do të përkrahet dhe nxitet në vazhdimësi botimi i teksteve universitare nga pedagogët si edhe do të zgjerohet baza e të dhënave që

studentët mund ta shfrytëzojnë edhe elektronikisht në bibliotekën e fakultetit.

Kujdes të veçantë do t'i kushtohet funksionimit të *grupeve kërkimore* brenda fakultetit të cilat do të kontribuojnë në rritjen e reputacionit dhe produktivitetit të kërkimit nëpërmjet:

- ✓ përqendrimit të ekspertizës të stafit në mënyrë që të konsolidohen anët e forta ekzistuese dhe ato potenciale të kërkimit.
- ✓ bashkëpunimit dhe mbështetjes për kërkuesit brenda grupeve për të realizuar projekte kërkimore të suksesshme të nevojshme për fuqizimin e kërkimit.
- ✓ fokusimit në programet dhe projektet e kërkim-zhvillimit të BE-së.
- ✓ nxitjen e kërkimit tek studentët sidomos te programeve Master dhe mbështetjen nëpërmjet trajnimit të tyre.
- ✓ promovimit të rezultateve kërkimore brenda dhe jashtë Universitetit

- 2.2 Nxitjen e kërkimit shkencor që mundëson për çdo anëtar praktika kërkimi rigoroze dhe etike, në kontekste të ndryshme profesionale, duke përfshirë edhe karrierën akademike në Universitet.

- 2.3 Rritjen e rolit kërkues të profileve të caktuara brenda secilit program nëpërmjet vënies në funksion të plotë të laboratorëve të tij.

3. Mjedisi i Fakultetit

Strategjitë që lidhen me *mjedisin e Fakultetit* do të synojnë:

- 3.1 Vazhdimësinë e punës dhe investimeve për një infrastrukturë më cilësore, të përshtatshme për mësim dhe punë.
- 3.2 Një mjedis funksional, përfshirës, dhe miqësor për studentët, që inkurajon mësimnxënien, angazhimin dhe autonominë e tyre.
- 3.3 Një mjedis funksional, përfshirës, eficient dhe miqësor për stafin, që mbështet cilësinë e lartë në mësimdhënie, kërkimin shkencor dhe administrimin.
- 3.4 Një mjedis ku i gjithë stafi të ndjehet i lirshëm për të kontribuar në mënyrë produktive për krijimin e një atmosfere besimi dhe respekti të ndërsjellët.

4. Zhvillimi i Fakultetit

Për të mbështetur rritjen dhe zgjerimin e programeve të studimit dhe kërkimit shkencor strategjitë për *zhvillimin e qëndrueshëm* të Fakultetit do të synojnë:

- 4.1 Angazhim gjithëpërfshirës të stafit të Fakultetit të Edukimit dhe Filologjisë në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare në fushat e edukimit, të disiplinave bazë, të didaktikës dhe pedagogjisë, në përputhje me prioritetet e zhvillimit të fakultetit si edhe të prioriteteve kombëtare të shpallura në thirrjet e projekteve në fjalë

- 4.2 Arritjen e standardeve të cilësisë në programet universitare me qëllim kalimin me sukses të procesit të akreditimit të gjithë programeve Brenda mandatit të ardhshëm.
- 4.3 Partneritetin në marrëdhënie me komunitetin në mënyrë që të rritet reputacioni i Fakultetit, kapacitetet e tij për t'u angazhuar në një proces kërkimi më produktiv dhe shërbime komunitare.
- 4.4 Praktika profesionale më eficiente në bashkëpunim me pushtetin lokal, DAR, shkollat e arsimit para universitar dhe gjithë aktorët lokalë të interesuar.

Profili dhe reputacioni i Fakultetit të Edukimit dhe Filologjisë në mësimdhënie dhe kërkim shkencor do të varet nga identifikimi dhe krijimi i partneriteteve të reja si dhe zgjerimi i atyre ekzistuese. Në këtë kontekst do të vazhdohet të investohet për rritjen e besimit dhe emrit të mirë të Fakultetit. Brenda kornizës së vlerave të Fakultetit, synimi do të jetë një përgjigje sa më fleksibël ndaj nevojave afatgjata të tregut.

Ky program do të plotësohet në vazhdimësi në bashkëpunim të ngushtë dhe duke përfshirë idetë dhe vendimmarrjen kolegjiale të planeve të zhvillimit të departamenteve si njësi vendimmarrëse të rëndësishme të universitetit tonë.

Studentët

Studentët janë aset i më i çmuar për fakultetin e Edukimit.

Të gjitha drejtimet e punës sonë; mësimdhënia, puna kërkimore shkencore, rritja e cilësisë së programeve të studimit dhe e formimit fillestar dhe të vazhduar të studentëve, promovimi i FEF me vlerat dhe arritjet e tij janë fryt i punës dhe investimit në edukim të brezave të pedagogëve në bashkëpunim dhe nën drejtimin e organeve dhe autoriteteve drejtuese.

Objekti ynë i vazhdueshëm në të gjitha këto fusha të rëndësishme të veprimtarisë akademike është realizimi i performancës më të lartë dhe kujdesi për rritjen cilësore të formimit dhe përgatitjes së studentëve për integrimin sa më të shpejtë dhe të suksesshëm në tregun e punës.

Për të realizuar këto detyra programi im për studentët do të sigurojë:

- Vëmendje të vazhdueshme dhe strategji të larmishme për të siguruar kontingjente të stabilizuara të studentëve në programet e mësuesisë.
- Sensibilizim i të gjithë aktorëve dhe bashkëpunëtorëve lokalë dhe më gjerë, i gjithë komunitetit për nevojën dhe domosdoshmërinë që ka komuniteti i rajonit juglindor për universitetin e Korçës si qendër e madhe zhvillimi në shërbim të shoqërisë dhe aspiratave të rinjve për formim cilësor dhe integrim të suksesshëm në tregun e punës. Në këtë kuadër programet e formimit në edukim dhe mësuesi janë investimi më i domosdoshëm dhe pragmatik për zhvillimin me hapa të shpejtë të shoqërisë.
- Diversifikim i ofertës akademike duke zhvilluar edhe programe të tjera në fushat me interes dhe në përgjigje të nevojave të tregut të punës.
- Ruajtje të lidhjeve të vazhdueshme dhe angazhim në projekte të reja me institucionet e arsimit Parauniversitar me qëllim promovimin e programeve të studimit dhe partneritetit kombëtar.
- Përfshirje aktive të studentëve në vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe në ristrukturimin e kurrikulave.
- Nxitje e kontributit të studentëve në fushat e kërkimit shkencor të departamentit duke u angazhuar në punimin e temave të diplomës në raport me prioritetet e vendosura në njësinë bazë.
- Plotësim i nevojave të studentëve në lidhje me aktivitetet jashtë-kurrikulare (projekte bamirësie, angazhime sociale, aktivitete artistike etj.)
- Promovim të punimeve të studentëve përmes veprimtarive të organizuara nga vetë ata në formën e sesioneve apo konferencave studentore në bashkëpunim me departamentet simotra të universiteteve në Shqipëri dhe në rajon.

- Rritje e angazhimit dhe formimit të studentëve për pjesëmarrje sa më të gjerë në projektet kombëtare dhe ato ndërkombëtare si Erasmus etj., për të promovuar vlerat e FEF si njësi e UK-së në formimin e një brezi të ri cilësor specialistësh në fushën e edukimit në vend por edhe në rajon e më gjerë.

Prof.as.dr. Pavllo CICKO

Kandidat për drejtues të Njesisë kryesore

FAKULTETI I EDUKIMIT DHE FILOLOGJISË